

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6554  
E mërkurë, 9 mars 2022  
çmimi 0.40 €

Osmani për medien amerikane: Putini po tenton të kryejë gjenocid, Zelensky shembull për gjithë botën | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

VAZHDON TË KUNDËRSHTOHET VENDIMI PËR RRIJTJEN E ENERGISË ELEKTRIKE NË KOSOVË | FAQE 4-5

## VENDIMI PËR RRIJTJEN E ENERGISË ELEKTRIKE PRITET TË PËRFUNDOJË NË KUSHTETUESE



Krahas rritjes së çmimit të energjisë elektrike, qytetarët e Kosovës janë duke u ballafaquar edhe me rritjen e çmimeve të gjërave elementare. Partitë opozitare qysh në fillim janë deklaruar kundër vendimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) për rritjen e çmimit të energjisë në vend. Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije të martën se janë duke i bërë përgatitjet që vendimin për rritjen e energjisë elektrike të dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese. Haradinaj e ka kritikuar kryeministrin Kurti, duke thënë se "populli nuk ushqehet me demagogji". "Qytetari i këtij vendi po përballet me pamundësinë për ta siguruar ekzistencën, po rriten çmimet e të gjithë artikujve të jetesës, rryma, nafta, vaji, sheqeri, buka, ilaçet, gjithçka tjetër", ka thënë Haradinaj

Ismail SYLA



### AKTUALE



BARAZIA GJINORE, THEMELI I BARAZISË SHOQËRORE | F. 5

TËRNAVA DHE ERBASH SHIKOJNË NGA AFËR PUNIMET NË XHAMINË QENDRORE NË PRISHTINË | F. 6

SHQIPËRIA BËHET ME RRUGËN "UKRAINA E LIRË" | F. 6

### EKONOMI



AMBASADORI AMERIKAN: DO TA NDIHMOJMË KOSOVËN PËR HAPJEN E VENDEVE TË REJA TË PUNËS | F. 8

BIZNESET KËRKOJNË NDRYSHIMIN E DISA NENEVE NË PROJEKTLIGJIN PËR MARKAT TREGTARE | F. 8

Në fund të muajit pritet të dëgjohet dëshmitari i mbrojtjes në rastin e Salih Mustafës | FAQE 3



ZPS-ja KËRKON TË ZBULOHET ÇDO PROVË NGA MBROJTJA E GUCATIT DHE HARADINAJT | FAQE 2

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Rusia po përgatitet për 'sulm të gjithanshëm' në Kiev

**KIEV, 8 MARS** - Mbi 1 200 civilë janë vrarë ose plagosur qëkur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt, ka njoftuar të martën Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB). Sipas kësaj organizate, ky numër përfshin 406 njerëz të vrarë dhe 801 të plagosur. Megjithatë, zëdhënësjja e Komisionarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Liz Throssell, ka paralajmëruar se shifrat "mund të jenë shumë më të larta". Shumica e lëndimeve janë rezultat i "sulmeve ajrore dhe të shtënave me armë", kanë thënë

ajo. Raportohet se është vrarë edhe një gazetar. OKB-ja ka shprehur, gjithashtu, shqetësim për, siç ka thënë, "ndalimin arbitrar" të mbështetësve pro-ukrainas në zonat që kontrollohen nga ushtria ruse, si dhe për "dhunën" kundër atyre që konsiderohen si pro-rusë në territoret e kontrolluara nga qeveria ukrainase. Më herët komisionari i lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, Filippo Grandi, ka thënë se numri i njerëzve të zhvendosur nga lufta në

Ukrainë ka kaluar dy milionë. Refugjatët kanë arritur këtë shifër vetëm në ditën e 13-të luftës. Grandi ka thënë se për krahasim, luftërat ballkanike në Bosnjë dhe Kosovë kanë shkaktuar dy-tre milionë të zhvendosur, por "në një periudhë prej tetë vjetësh". Numri më i madh i refugjatëve ukrainas ka hyrë në Poloni: mbi 1.2 milion. Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt, pasi nuk ka marrë garanci nga NATO-ja se nuk do të zgjerohet më drejt lindjes.



## "Shell"-i tërhiqet nga Rusia



**LONDËR, 8 MARS** - Gjiganti "Shell" ka njoftuar se do t'i ndalojë të gjitha blerjet e naftës dhe gazit nga Rusia dhe se do t'i mbyllë operacionet e tjera në këtë vend. Me këtë veprim, "Shell"-i u është bashkuar dhjetëra kompanive të tjera që kanë ndërprerë lidhjet me Rusinë për shkak të pushtimit të paprovokuar të Ukrainës. "Shell"-i është kritikuar shumë në fundjavë, pasi ka blerë një ngarkesë të naftës së papërpunuar ruse me një çmim të zbritur.

Shefi i kompanisë, Ben van Beurden, ka thënë të martën se blerja e naftës ruse ka qenë gabim. "Ne jemi shumë të vetëdijshëm se vendimi ynë javën e kaluar, për të blerë një ngarkesë me naftë bruto ruse, nuk ka qenë i duhuri dhe na vjen keq", ka thënë van Beurden. Kompania shumëkombëshe e energjisë, "Shell", ka selinë në Londër. Menjëherë pas njoftimit të saj, ministri i Jashtëm i Ukrainës, Dmytro Kuleba, ka reaguar në llogarinë

e vet në "Twitter", duke thënë se i është mirënjohës "Shell"-it për këtë "hap moral dhe të përgjegjshëm". Kuleba ka inkurajuar edhe bizneset e tjera botërore që ta ndjekin shembullin. Moska ka filluar pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt. Që atëherë më shumë se 2 milionë civilë janë larguar nga vendi i pushtuar. Dhjetëra kompani, përfshirë firma të mëdha të sektorit të naftës, si "BP" dhe "Exxon" janë tërhequr nga Rusia.

## Bideni pritet t'i ndalojë importet për naftën dhe gazin rus

**WASHINGTON, 8 MARS** - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, pritet t'i ndalojë importet e naftës, gazit natyror dhe qymyrit rus në ShBA, raporton "CNN" brenda burimeve në

Shtëpinë e Bardhë. ShBA-ja do ta bëjë këtë lëvizje në mënyrë të njëanshme, pa aleatët e saj evropianë, për shkak të mosmarrëveshjes midis vendeve evropiane për ndalimin e energjisë ruse.

Vendet e BE-së rrezikojnë humbje shumë më të madha nga energjia ruse se ShBA-ja, raporton "CNN". "Zyrtarët amerikanë vendosën, duke pasur parasysh presionin ekstrem politik në vend, se ata

mund të lëviznin pa koalicionin dhe të mos krijonin mosmarrëveshje", ka thënë ky burim. Presidenti Bideni pritet t'i drejtohet opinionit të enjten, duke filluar nga ora 10:45.



## Ministri britanik: Pushtimi i Ukrainës do të shënojë rënien e Putinit

**LONDËR, 8 MARS** - Sekretari britanik i Mbrojtjes, Ben Wallace, ka thënë se pushtimi i Ukrainës do të shënojë rënien e presidentit rus, Vladimir Putin. Wallace ka thënë se forcat ruse, që janë angazhuar në pushtimin e Ukrainës, janë "rraskapitur" tashmë nga rezistenca e forcave lokale. Ai ka thënë se ushtria ruse po përballet me probleme logjistike dhe ka pësuar mijëra humbje në 13 ditët e para të pushtimit.

Wallace ka thënë se është "detyrë e pamundur" të pushtosh një vend me 44 milionë banorë. "Ky do të jetë fundi i Putinit dhe kështu duhet të jetë", ka thënë Wallace për "BBC"-në. Sipas tij, Putin është tashmë "një forcë e shpenzuar" në botën e gjerë, sepse komuniteti ndërkombëtar ka konstatuar se pushtimi i Ukrainës dhe katastrofa humanitare që ai ka shkaktuar, "janë të papranueshme". Sanksionet ndërkombëtare, të

vendosura ndaj Rusisë, "po e zvogëlojnë ekonominë e tij në zero" dhe Putin "është përgjegjës për këtë", ka thënë Wallace. Perëndimi ka ndërmarrë një varg sanksionesh ekonomike dhe diplomatike kundër Rusisë, pasi kjo e fundit ka nisur pushtimin e Ukrainës, më 24 shkurt. Putini ka dhënë urdhrin për pushtim pasi nuk ka marrë garanci nga NATO-ja se nuk do të zgjerohet më drejt lindjes.





# ZPS-ja kërkon të zbulohet çdo provë nga mbrojtja e Gucatit dhe Haradinajt

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 MARS - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka kërkuar nga trupi gjyqësor, i kryesuar nga Charles L. Smith II, që ta urdhërojë mbrojtjen e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, që të zbulojnë çdo provë të mëtejshme që ata kërkojnë të shqyrtohen për dënim deri të premtën në orën 16:00.

Kjo është bërë me dije përmes shkresës që ZPS-ja ia ka drejtuar trupit gjyqësor, e cila është publikuar në faqen zyrtare të gjykatës.

Në këtë shkresë është thënë se në përputhje me urdhrin për mbylljen e provave, mbrojtja e Gucatit ka dorëzuar përmbledhjen e saj përfundimtare duke treguar se çfarë provash shtesë do të merrte në konsideratë gjatë dënimit.

Ndërsa mbrojtja e Haradinajt nuk i ka trajtuar çështjet e dënimit në përmbledhjen e saj përfundimtare, duke e bërë të paqartë se çfarë provash të tjera mund të kërkojë të paraqesë nëse ka. "Asnjë nga provat e paralajmëruara nga mbrojtja e Gucatit nuk janë zbuluar. As nuk ka ndonjë indikacion, duke vënë

në dukje rregullin e përgjithshëm në Dhomat e Specializuara që aktgjykimi dhe dënimi të shqiptohen njëkohësisht - pse kjo dëshmi nuk mund të ishte ofruar më parë gjatë prezantimit të provave të mbrojtjes?", është thënë në shkresën e ZPS-së.

Sipas shkresës, ZPS-ja duhet të ketë njoftim për çdo provë shtesë të propozuar për dënim, në mënyrë që ta paraqesë pozicionin e saj të plotë në fjalët përfundimtare. "Për më tepër, mbrojtjes nuk duhet t'i lejohet ta detyrojë trupin gjyqësor në një procedurë të dyfishtë duke vonuar zbulimin e çdo prove që dëshiron të paraqesë për dënim", është thënë në shkresën e ZPS-së. Së fundi, sipas prokurorisë, duke pasur parasysh natyrën e këtij rasti, njoftimin e dhënë për të akuzuarit, burimet në dispozicion të ekipeve të mbrojtjes dhe shtrirjen e kufizuar të çdo prove që mund të ofrohet gjatë dënimit në këtë fazë, nuk ka asnjë arsye pse mbrojtja nuk duhet të jetë në gjendje t'i paraqesë provat e propozuara deri në këtë të premtë, 11 mars 2022. "Prandaj, ZPS-ja kërkon nga trupi gjyqësor që ta urdhërojë mbrojtjen e Gucatit dhe mbrojtjen e



Haradinajt që të zbulojnë çdo provë të mëtejshme që ata kërkojnë të shqyrtohen për dënim deri në orën 16:00 të së premtes, 11 mars 2022", është thënë në fund të shkresës.

Hysni Gucati së bashku me Nasim Haradinajt po akuzohen për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës. "Akuzat e paraqitura në aktakuzën e konfirmuar

mbështeten në dyshimin e bazuar mirë se, së paku midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, z. Gucati dhe z. Haradinajt zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat, të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm), në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si edhe përmes shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjetet sociale", ishte thënë në njoftimin e Dhomave të Specializuara. Gucati dhe Haradinajt

ngarkohen se kanë bërë komente nënçmuese kundër dëshmitarëve të mundshëm dhe në mënyrë të përsëritur shprehën synimin e tyre për ta dëmtuar punën e Dhomave të Specializuara. "Me këto veprime, z. Gucati dhe z. Haradinajt shkelën fshehtësinë e procedurës dhe frikësuan dëshmitarë (të mundshëm) të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe, si pasojë, penguan punën dhe hetimet e ZPS-së", ishte thënë në njoftimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

## Rama: Çmimi i naftës nuk varet nga qeveria, duhet të përgatitemi për çdo skenar



TIRANË, 8 MARS (ER) - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka theksuar se çmimi i naftës nuk varet nga qeveria shqiptare, por nga tregu, i cili është ndikuar nga lufta në Ukrainë. Rama ka theksuar se duhet të përgatitemi për çdo skenar të mundshëm që mund të ndodhë, ndërsa lufta ka prekur të gjithë botën. "Kriza energjetike po vjen duke u rritur. Një prej zyrtarëve rus ka kërcënuar me një çmim 300 dollarë për fuçi, një gjë e pandodhur në historinë e tregtisë. Çmimi i naftës rritet dita ditës. Një ndryshim tektonik me pasoja. Shqipëria nuk bën asnjë përjashtim. Është drejtpërdrejt e prekur si të gjithë vendet e tjera. Çmimi i naftës ndikohet drejtpërdrejt nga tregu, jo nga vendimet e qeverisë", ka thënë

Rama. Në Ukrainë po zhvillohet një luftë ushtarake, kurse në të gjithë Evropën një luftë ekonomike me pasojë rritje të çmimeve. "Çmimi i naftës nuk varet nga qeveria. Nuk është qeveria në tregun e lirë. Evropa ka hyrë në luftë. Ushtarakisht është mes një agresori dhe një vendi në agresion, ndërsa në të gjitha aspektet e tjera, lufta zhvillohet mes të gjitha vendeve që refuzojnë agresorin dhe agresorin. Në luftë nuk ka mundësi për të kërkuar të njëjtat gjëra që kërkohim përpara fillimit të luftës dhe se duhet të përgatitemi për çdo skenar. Askush nuk e di se sa do të vijojë kjo luftë. Nuk është një film ai që shikojmë në ekrane orë e çast", ka thënë Rama.

## Në fund të muajit pritet të dëgjohet dëshmitari i mbrojtjes në rastin e Salih Mustafës

PRISHTINË, 8 MARS (ER) - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë është mbajtur konferenca përgatitore për mbrojtjen e ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa - Cali. Palët kanë diskutuar me trupin

gjyqësor rreth afateve për paraqitjen e provave nga mbrojtja, ku avokati Julius Von Bone ka deklaruar se planifikojnë të fillojnë me deklaratën hapëse në fund të muajit mars e të cilën e pason dëgjimi i dëshmitarit të parë të

mbrojtjes. Paraqitja e dëshmitarëve dhe provave nga ana e mbrojtjes vjen pasi Zyra e Prokurorit të Specializuar e ka mbyllur zyrtarisht çështjen e saj më 4 shkurt. "Le të mendojmë që do të fillojmë me datë 23 mars me deklaratën hapëse

dhe do ta vijojmë ditën tjetër me dëshmitarin e parë. Dëshmitari i parë do të ishte dëshmitari i dytë i renditur në listë apo jo?", ka thënë avokati Von Bone. Ai ka thënë se i duhen dy orë për ta paraqitur deklaratën hapëse.







VAZHDON TË KUNDËRSHTOHET VENDIMI PËR RRIJTJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË

## Vendimi për rritjen e energjisë elektrike pritet të përfundojë në Kushtetuese

Krahas rritjes së çmimit të energjisë elektrike, qytetarët e Kosovës janë duke u ballafaquar edhe me rritjen e çmimeve të produkteve elementare. Partitë opozitare qysh në fillim janë deklaruar kundër vendimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) për rritjen e çmimit të energjisë në vend. Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije të martën se janë duke i bërë përgatitjet që vendimin për rritjen e energjisë elektrike të dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese. Haradinaj e ka kritikuar kryeministrin Kurti, duke thënë se “populli nuk ushqehet me demagogji”. “Qytetari i këtij vendi po përballet me pamundësinë për ta siguruar ekzistencën, po rriten çmimet e gjithë artikujve të jetesës, rryma, nafta, vaji, sheqeri, buka, ilaçet gjithçka tjetër”, ka thënë Haradinaj

ushqyer me ideologji dhe me artin e kulturën që e kanë prodhuar ato, e të cilat kryeministri Kurti po i përdorë me aq pafytyrësi. Prandaj, ne nuk e kemi ndër mend të ndalemi së demaskuari këtë qeveri të dëmshme, pa marrë parasysh fuqinë tonë opozitare në Kuvend, por gjithnjë me shpresë se do të rritet populli opozitar që nuk do të bie pre e mashtrimeve dhe fjalëve të bukura të kryeministrit e që, kurdoherë, do t’ia japë përgjigjen që e meriton”, është shprehur Haradinaj.

Më tutje, Haradinaj ka thënë se vendimi i qeverisë Kurti për të mos u rritur çmimet e rrymës për serbët në veri është diskriminues. Haradinaj ka thënë se qytetarët e Kosovës nuk janë duke u ballafaquar vetëm me rritjen e energjisë elektrike. “Kryeministër, nuk ushqehet populli me ideologji. Situata në Kosovë është shumë më e komplikuar, nuk është veç punë naftë e punë akcize. Qytetari i këtij vendi po përballet me pamundësinë për ta siguruar ekzistencën, po rriten çmimet e gjithë artikujve të jetesës, rryma, nafta, vaji, sheqeri, buka, ilaçet dhe gjithçka tjetër. Kemi qenë të shqetësuar gjatë gjithë këtyre muajve të veprimeve të kësaj qeverie antipopullore. Ka më shumë se 6 muaj që bëjmë presion te kjo qeveri që ta

miratojë Ligjin e Pagave dhe rritjen e pagës minimale, e s’ka asnjë veprim. Përkundrazi, ajo e rritë çmimin e energjisë për qytetarët shqiptarë, ndërkaq për serbët në veriun e vendit, vendos t’ua paguajë rrymën nga buxheti i shtetit”, ka deklaruar Haradinaj. Kujtojmë se më 8 shkurt Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka aprovuar tarifën e energjisë elektrike për vitin 2022. Sipas vendimit, bllok tarifa do të zbatohet për konsumatorët që harxhojnë mbi 800 kWh. Për këta konsumatorë rritja e çmimit të rrymës do të jetë rreth 100 për qind. “Tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët jofamiljarë, në kuadër të shërbimit universal, do të mbesin të njëjta si në vitin e kaluar. Tarifat për konsumatorët familjarë, për nivelin e konsumit deri në 800 kWh në muaj, do të mbesin të njëjta, ndërsa diferenca e konsumit mbi 800 kWh për muaj do të faturohet me tarifën e ulët (gjatë natës) prej 5.9 dhe tarifën e lartë (gjatë ditës) prej 12.52 centësh”, kishte bërë me dije ZRRE-ja.

Fillimisht ZRRE-ja kishte propozuar që bllok tarifa të aplikohet nga 600 kilovatë në orë por, pas shqyrtimit të komenteve të shumë institucioneve, ZRRE-ja ka ndryshuar propozimin e saj. Vendimi i ZRRE-së për

shtrënjtimin e energjisë ishte marrë në vijë me propozimin e Lëvizjes Vetëvendosje dhe Ministrisë së Ekonomisë që kishin dorëzuar në këtë institucion.

Partitë opozitare e kishin kundërshtuar vendimin e ZRRE-së për shtrënjtimin e energjisë elektrike. Lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, kishte deklaruar se vendimi është marrë me bekimin e plotë të qeverisë së drejtuar nga Albin Kurti. “Në koordinim direkt dhe me bekimin e plotë të qeverisë dhe kryeministrit Albin Kurti, sot ZRRE zyrtarizoi vendimin e paralajmëruar për rritjen e çmimit të energjisë elektrike, duke e vulosur rëndimin e mëtejshëm të jetës dhe mirëqenies së qytetarëve të Kosovës. Që nga fillimi i mandatit të saj, qeveria Kurti ka dështuar të ndërmarrë çfarëdo hapi për ta zhvilluar ekonominë e vendit, të rënduar shumë gjatë pandemisë, duke qenë e paafte t’i adresojë kërkesat dhe nevojat e bizneseve, shumë prej të cilave i solli në prag të falimentimit. Për më shumë, qeveria ka dështuar të ndërmarrë masa, ta parandalojë përkeqësimin dhe ta lehtësojë barrën sociale për familjet e Kosovës përballë rritjes së vazhdueshme të çmimeve në çdo produkt esencial”, kishte thënë Krasniqi.

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 8 mars (ER)** - Ish-kryeministri i Kosovës dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se janë duke u përgatitur që çështjen e rritjes së tarifave të energjisë elektrike ta dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese. “Sot e kemi nisur procedurën që këtë diskriminim ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese, si shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut. Përfundimisht, situata në Kosovë kurrë nuk ka qenë më e rëndë,

edhe në aspektin e ekzistencës, edhe të sigurisë. Kryeministri në vend që të veprojë, po mban fjalime letrare dhe filozofike në Kuvend. Nuk ushqehet populli as me ideologji, as me ëndrra. Nuk mashtrohen njerëzit me fjalë të bukura. Nuk mbahet shpija me llafë. Qeveria po kujton se mund të tallet me qytetarët e vendit, duke i lajthitur me do farë ‘epopesh të arsimit’, ka thënë Haradinaj, duke shtuar se si opozitë do ta demaskojnë qeverinë e drejtuar nga kryeministri Albin Kurti. “Kanë vdekur sistemet kur popujt janë



# Barazia gjinore, themeli i barazisë shoqërore

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 MARS - Në ngjarjen e organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, me temën "Zhbëjmë paragjykimet, punojmë për gjithëpërfshirjen", me rastin e Ditës së Gruas, 8 Marsit, kryeministri Albin Kurti u shpreh i nderuar që sot në këtë ditë të veçantë të bashkëbisedohet për zhbërjen e paragjykimëve dhe punën për gjithëpërfshirje.

Kurti ka thënë se barazia gjinore është themeli i barazisë shoqërore. "Për zhvillimin e gjithëmbarshtëm parakusht është zhvillimi i kapitalit njerëzor, e qasja e barabartë në mundësitë për zhvillim, për gratë dhe burrat, e vajzat dhe djemtë. Gratë e bëjnë aktivizmin e dyfishtë: merren me politikën e përgjithshme, por gjithsesi edhe me çështjet gjinore. Gratë nuk punojnë vetëm për gratë, por ato punojnë edhe për gratë, sidomos për gratë. Duhet t'i aktivizojmë gratë e shkolluara e duhet t'i shkollojmë sa më lart gratë aktive", ka theksuar kryeministri Kurti. Ai ka veçuar

disa nga të arriturat në këtë fushë si atë për ndarjen e shtesave për më shumë se 142 mijë fëmijë të porsalindur brenda këtij viti e kjo, sipas tij, për të arritur rezultate të drejta në rrugëtimin e përbashkët, është e domosdoshme barazia në fillim të shtegut.

Pastaj, për ta ndihmuar avancimin e vajzave në shkencë, këtë vit akademik kryeministri Kurti ka thënë se janë ndarë 1 365 bursa për vajzat në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës si dhe janë duke finalizuar projektligjin për tekstet shkollore që në fokus, ndër të tjera, ka edhe promovimin e barazisë në tekste, pa dallim gjinie, përkatësie fetare, etnike a racore, ndryshim të normave patriarkale e formësimit të duhur mbi rolet gjinore. "Krijimi i mundësive të barabarta është objektiv i parë strategjik në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, që gratë të përfitojnë nga zhvillimi, por edhe të kontribuojnë që të rritim përfshirjen e pjesëmarrjen aktive", ka thënë ai.

Kurti ka shtuar se me Pakon e



Ringjalljes Ekonomike kanë zbatuar masa aktive për punësimin e grave, nga të cilat kanë përfituar mbi 3 000 gra dhe vajza. "Ndërsa kemi zbatuar edhe masa të tjera mbështetëse për gratë, si ajo për lehonat, nga të cilat vazhdojnë të përfitojnë rreth 12 000 nëna të reja", është

shprehur Kurti. Ai ka bërë me dije se vitin 2022 e kanë filluar me miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave. "Një shoqëri ku të gjithë janë të sigurt dhe të barabartë, jetojnë pa frikën apo kërcënimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, ku

qëllim është të parandalohet dhe mos të tolerohet dhuna, të mbrohet, riintegrohet dhe fuqizohet viktimi, si dhe të vendoset kryerësi para përgjegjësisë", ka thënë Kurti, duke potencuar se ky është vizioni i kësaj strategjie, që do ta drejtojë punën tonë të përbashkët.

## Osmani për mediumin amerikan: Putini po tenton të kryejë gjenocid, Zelensky shembull për gjithë botën

PRISHTINË, 8 MARS - Presidentja Vjosa Osmani, në një intervistë për mediumin amerikan "HuffPost", ka thënë se presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky është një shembull për gjithë botën derisa përfaqësonin e tij rus, presidentin Vladimir Putin, ka thënë se është duke tentuar të kryejë gjenocid në Ukrainë.

Osmani ka thënë se deklaratat e presidentit rus për "denazizmin" e fqinjët të tij tregonin për një synim "për të shkatërruar tërësisht ose pjesërisht popullin e Ukrainës". Osmani për mediumin amerikan tha se konflikti në Ukrainë i ka sjellë edhe "kujtime personale" të luftës së Kosovës. "Është absolutisht shkatërruese për të gjithë njerëzit e Kosovës të shohin këto imazhe të cilat për ne sjellin shumë kujtime personale. Ajo që ne shohim në Ukrainë është shumë e ngjashme - gra që përthunohen, civilë po vriten,



fëmijë të vegjël po ashtu vriten, njerëz që po detyrohen të lënë shtëpitë e tyre është absolutisht e dhimbshme. Kanë kaluar 20 vjet, kështu që kujtimet për ne janë shumë të freskëta", ka

thënë Osmani. Presidentja ka thënë se ajo besonte se Ukraina tani ishte viktimë e një "regjimi gjenocidal brutal" të ngjashëm me atë që kishte në shënjestër

Kosovën në fund të viteve 1990 dhe që e detyroi NATO-n të niste një fushatë bombardimesh pasi përpjekjet diplomatike për të rivendosur paqen dështuan. "Si një ish-profesoreshë e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit, ne i njohim ato kur i shohim. Qëllimi këtu është i qartë dhe qëllimi është elementi kryesor i gjenocidit. Unë besoj se tashmë ka shumë prova që gjykatat ndërkombëtare do të përdornin kundër Putinit dhe kundër qeverisë ruse për krimet që po kryejnë kundër Ukrainës. Kam besim që këto krime nuk do të mbesin të pandëshkuara. Fatkeqësisht, në rastin e ish-Jugosllavisë, ato mbesin të pandëshkuara. Plagët janë të hapura", ka thënë Osmani.

Presidentja e Kosovës ka thënë se është inkurajuese përgjigjja e Perëndimit për dënimin e pushtimit të Ukrainës nga Putini, por ka shtuar se "duhet të

bëhet më shumë si në aspektin e sanksionimit ekonomik, sidomos kur vjen puna te politika për të hapur dyert për refugjatët ukrainas". Osmani ka folur edhe për periudhën e errët të Kosovës gjatë luftës, duke thënë se kosovarët e dinë mirë çfarë po përjetojnë ukrainasit tani. Ajo, gjithashtu, ka përmendur Serbinë si "i vetmi vend në Evropë ku ka protesta pro Putinit". "I vetmi vend në këtë pjesë të botës dhe Evropës, përveç regjimit të Lukashenkos (në Bjellorusi) që nuk ka vendosur sanksione kundër Rusisë, është Serbia. Fakti që ai (presidenti serb Aleksandër Vuçiq) nuk u pajtua për të vendosur sanksione kundër Rusisë tregon se ai qëndron qartë me Rusinë në këtë çështje. Dhe derisa në vitet 1990 Slllobodan Millosheviqi me të vërtetë kreu krime në atë masë sa u quajt me të drejtë kasapi i Ballkanit, Putini tani është kasapi i demokracisë", ka thënë Osmani.

Edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, kishte thënë se çmimi i energjisë elektrike është rritur me urdhër të qeverisë Kurti. Në një konferencë për medie ai kishte thënë se tarifa e lirë e

energjisë është rritur 104 për qind. "Kjo konferencë është si rezultat i vendimit të sotëm të bërë publik, vendim i qeverisë, i kamufluar nën petkun e ZRRE-së për shtrenjtimin astronomik të

energjisë elektrike në Kosovë. Ky vendim i kamufluar përmes ZRRE-së parasheh që çdo shpenzim mbi 800 kilovatë në orë do ta paguajnë tarifën e shtrenjtë nga 6.75 centë sa është sot, në

12.5 centë, pothuajse dyfish më shtrenjtë. Ndërkaq tarifën e lirë nga 2.89 centë sa është sot, në 5.9 centë apo 104 për qind më shtrenjtë", ka thënë ai. Kundër vendimit të ZRRE-së për

shtrenjtimin e energjisë elektrike janë organizuar edhe protesta dhe është mbajtur një seancë e jashtëzakonshme parlamentare, e cila nuk ka pasur ndonjë efekt në raport me këtë vendim.



## Shqipëria bëhet me rrugën 'Ukraina e Lirë'

**TIRANË, 8 MARS (ER)** - Zëvendësministria e Brendshme e Shqipërisë, Romina Kuko, njëherësh kryetare e Këshillit Bashkiak të Tiranës, ka thënë se të hënën, më 7 mars, Këshilli i Tiranës ka votuar në të mirë të emërtimit të një rruge në Tiranë, "Ukraina e Lirë". Në këtë rrugë, sipas saj, gjenden ambasada e Ukrainës, e Kosovës, e Serbisë dhe e Rusisë. "Në mbledhjen e

sotme Këshilli Bashkiak Tiranë, krahas pikave të grumbullimit të ndihmave për popullin e Ukrainës dhe gatishmërisë së 1 500 qytetarëve për t'i mirëpritur familjet në nevojë, në shenjë simbolike emërtoi rrugën e cila lidh ambasadën e Ukrainës, të Kosovës, të Federatës Ruse dhe asaj të Serbisë si Rr. 'Ukraina e Lirë'", ka shkruar Kuko në "Facebook".

Sulmi i Moskës ndaj Ukrainës ka nisur në orët e para të 24 shkurtit.

Presidenti rus, Vladimir Putin, ka urdhëruar "operacion special" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Veprimi i Kremlinit ka nxitur zemërim dhe është dënuar në shumë vende të botës. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët janë përgjigjur me sanksione të ashpra kundër Moskës.



## Policia vazhdon planet operative për ngritjen e sigurisë në trafik



**EPOKA E RE**

**Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 8 MARS** - Policia e Rajonit të Prishtinës, respektivisht Njësi Rajonal i Trafikut rrugor, po vazhdon zbatimin e planeve operative për kontrollin e shtuar në trafik. Gjatë tri ditëve të fundit nga njësi i trafikut janë shqiptuar 541 tiketa për kundërvajtje. Për mosrespektim të shpejtësisë së kufizuar janë shqiptuar 322 tiketa, për tejkalim në vijë të plotë apo vend të ndaluar tri tiketa, për vozitje nën ndikim të alkoolit janë shqiptuar pesë tiketa, për drejtim të mjetit pa patentë shofer janë shqiptuar gjashtë tiketa, për mosvënie të rripit të sigurisë janë shqiptuar 62 tiketa, për skadim të afatit të regjistrimit të automjetit janë

shqiptuar 17 tiketa, për kyçe të parregullt në rrugën kryesore janë shqiptuar 21 tiketa, për xhamat e errët, vendosje të foljes ose materialit tjetër janë shqiptuar dhjetë tiketa, për përdorim të telefonit mobil gjatë drejtimit të mjetit janë shqiptuar dymbëdhjetë tiketa, ndërkaq tiketa të tjera janë shqiptuar 83. "Në këtë periudhë kohore janë konfiskuar përkohësisht 14 patentëshoferë në kohëzgjatje prej 3 deri në 12 muaj. Duke kërkuar kujdes të shtuar, për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, ju njoftojmë se operacionet për siguri në rrugë do të kenë shtrirje në të gjitha rrugët e rajonit të Prishtinës dhe do të vazhdojnë derisa të vlerësohet që është arritur efekti i dëshiruar", ka njoftuar Policia e Kosovës.

## Tërnavë dhe Erbash shikojnë nga afër punimet në xhaminë qendrore në Prishtinë

**PRISHTINË, 8 MARS (ER)** - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), myftiu Naim Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, ka pritur të martën në takim kryetarin e Bashkësisë Islame të Turqisë, Ali ef. Erbash. Tërnavë i ka uruar mirëseardhje Erbashit në Kosovë derisa, siç është thënë në njoftimin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ai e ka cilësuar këtë vizitë si shumë domethënëse për popullin e Kosovës, "marrë parasysh të kaluarën historike të përbashkët ndërmjet dy popujve". Pas takimit ata kanë shikuar nga

afër punimet që janë duke u bërë në xhaminë qendrore në Prishtinë.

Me këtë rast, kryetari i Bashkësisë Islame të Turqisë, Ali ef. Erbash, ka thënë se ndihet i lumtur që ky projekt do të realizohet në bashkëpunim me kryesinë e BIK-ut. Ai e ka lutur Zotin që punimet të ecin mbarë dhe sipas planit të paraparë. Gjatë kësaj vizite myftiu Tërnavë dhe kryetari Erbash kanë zhvilluar një bisedë telefonike me presidentin e Turqisë, Rexhep Taip Erdogan, të cilin e kanë njoftuar për së afërmi me mbarëvajtjen e punimeve të xhamisë qendrore në Prishtinë.



## Në QKUK kryhet një operacion i komplikuar, i shpëtohet jeta një 55 vjeçi

**PRISHTINË, 8 MARS (ER)** - Puna ekipore e mjekëve të disa klinikave të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, nën udhëheqjen e kirurgut vaskular, anesteziologut, kirurgut torakal, kardiokirurgut dhe ekipit

përcjellës ka shpëtuar jetën e një 55 vjeçi të therur me thikë. Sipas QKUK-së, pacienti i therur me thikë në shpinë kishte pësuar lëndim të aortës së gjoksit, kurse pas mobilizimit të ekipeve kujdestare dhe operacionit

që ka zgjatur disa orë është arritur të shpëtohet jeta që po i rrezikohej çdo çast. "Përveç lëndimit të aortës së gjoksit kishte edhe dëmtim të pjesërishëm të palcës së kurrizit. Operacioni ishte shumë kompleks dhe është

kryer me sukses të plotë. Lëndimet e tilla në shumicën e rasteve janë fatale për pacientin. Në QKUK është hera e parë që kryhet ky lloj i intervenimit të rëndë", ka njoftuar QKUK-ja.





## Ambasadori amerikan: Do ta ndihmojmë Kosovën për hapjen e vendeve të reja të punës

PRISHTINË, 8 MARS (ER) - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Jeff Hovenier, në takim me ministren e Tregtisë dhe Industrisë, Rozeta Hajdari, ka thënë se Amerika është e përkushtuar ta ndihmojë Kosovën në aspektin ekonomik. Ai ka thënë se vendi i tij do t'i vazhdojë angazhimet për ndërtimin e një ekonomie të

qëndrueshme kosovare, që tërheq investime të huaja dhe krijon vende pune dinamike për të gjithë qytetarët e Kosovës, përfshirë të rinjtë.

Ndërsa ministrja Hajdari ka folur për objektivat e ministrisë që drejton, lidhur me zhvillimin e industrisë, inovacionit, ndërmarrësisë, turizmit, si dhe tërheqjen e investimeve, me qëllim të

rritjes së punësimit dhe përmirësimit të bilancit tregtar me bazë në parimet e përgjegjësisë, llogaridhënies, transparencës, barazisë dhe gjithëpërfshirjes.

Të dyja palët kanë shprehur gatishmërinë për shtimin e bashkëpunimit në fushat që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe integrimin euroatlantik të Republikës së Kosovës.



## Bizneset kërkojnë ndryshimin e disa neneve në Projektligjin për markat tregtare

PRISHTINË, 8 MARS - Në Komisionin për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti është mbajtur një dëgjim publik për dy projektligje, atë për markat tregtare dhe për mbrojtjen e sekreteve tregtare, për çka pati sugjerime dhe vërejtje rreth këtyre projektligjeve nga përfaqësuesit e bizneseve dhe të avokatisë.

Përfaqësuesit e bizneseve dhe të avokatisë me këtë rast kërkuar ndryshimin e disa neneve që mundësojnë regjistrimin e markave tregtare.

Pikërisht për këto kritika, kryesuesi i grupit punues, deputeti Driton Hyseni, ka kërkuar nga bizneset dhe palët e interesit që t'i dorëzojnë komentet e tyre, për t'i paraqitur pastaj ky komision në formë të amendamenteve. "Si grup punues kemi për detyrë që t'i shqyrtojmë këto dy projektligje nen për nen dhe t'i paraqesim komisionit pastaj amendamentet të cilat vijnë qoftë nga ana juaj, apo nga palët e tjera të interesit që mund të shfaqin interesim. Sipas mendimit tuaj do të kërkoj që ju të na tregoni se a janë përcaktuar saktë kushtet dhe procedurat për regjistrimin e markave tregtare. A mbrohen të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave? A mendoni se me miratimin e këtij ligji plotësohen nevojat institucionale në drejtim të përmbushjes së nevojave që ka shoqëria jonë? A sigurohet mbrojtja e konsumatorit si dhe zhvillimi i sferës së



pronësisë industriale të Kosovës", ka theksuar Hyseni. Kryesuesja e Komitetit për çështje ligjore në Odën Ekonomike Amerikane, Kujtesa Nezaj-Shehu, pati vërejtje për nenin 6 dhe 7. Përveç këtyre, ajo ka kritikuar Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për mospërfshirje në draft-ligj edhe të komenteve të shoqatave ndërkombëtare për markat tregtare "IMPA". "Kur shikova sot draft-ligjin pashë që disa komente që i ka dërguar shoqata ndërkombëtare për markat

tregtare 'IMPA', e cila ka një reputacion, nuk janë marrë për bazë asnjë prej tyre. Njëkohësisht, përveç këtyre komenteve që i ka dorëzuar 'IMPA', unë i kam edhe disa komente. I pari ka të bëjë me nenin 6 dhe 7, që janë shkaqet absolute dhe shkaqet relative për refuzim të një regjistrimi dhe ka të bëjë me atë kur mund të refuzohen aplikimet që paraqiten me keqbesim", ka thënë ajo.

Edhe avokatja Zanita Leka nga Oda e Avokatëve të Kosovës ka kërkuar nga grupi punues plotësimin e nenit 15 të

Projektligjit për markat tregtare. "Në nenin 15, ku ceket përjashtimi i një deklarate pavlefshmërie për shkak të tolerimit, është cekur decitivisht se, kur pronari i markës së mëhershme ka toleruar pa kundërshtim për një periudhë pesëvjeçare, konsideroj se vetëm si heshtje ka mbetur kjo por, ndoshta, është më mirë të shtohet si nen ose si dispozitë në po këtë nen, ose të përfshihet në këtë dispozitë që atij ose asaj t'i merret një pëlqim me shkrim brenda kësaj periudhe në mënyrë që më vonë të mos

dalim probleme me gjykata", ka theksuar Leka.

Isa Dukaj, nga Agjencia për Pronësi Industriale, ka thënë se ndër problemet me të cilat ballafaqohet Kosova është fakti se Kosova nuk është pjesë e Kombeve të Bashkuara. Dhe kjo, sipas tij, i pengon edhe bizneset e huaja të regjistruar në Kosovë. Komuniteti i bizneseve, dhe çdo palë tjetër e interesit, mund t'i dorëzojnë komentet e tyre në formë të shkruar në adresën elektronike në Komisionin për Ekonomi deri më 11 mars.

## Guvernatori i BQK-së takon komisionaren për informim dhe privatësi

PRISHTINË, 8 MARS (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka pritur në takim komisionaren për informim dhe privatësi, Krenare Sogojeva-Dermaku. Në takim guvernatori Mehmeti dhe komisionarja Sogojeva-

Dermaku u pajtuan ta rritin nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve dhe veprimeve në kuadër të fushëveprimtarive, kompetencave dhe autorizimeve të të dyja institucioneve. Mes të tjerash,

dy institucionet u pajtuan për ngritjen e mekanizmave koordinues të cilët do të jenë në komunikim të vazhdueshëm për çështje të interesit të përbashkët në zbatim të legjislacionit dhe autorizimeve që kanë institucionet tona.





# As Beogradi, as Moska, as kundërshtarët politikë nuk mund ta ndryshojnë historinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!



Ismail SYLA

Sot Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës po prek afër çerekshekullin, ndërkaq bota ka drejtuar sytë dhe ka hapur veshët nga zhvillimet dramatike në Ukrainë, ku po sulmohet me gjakftohtësi siberiane një komb dhe një shtet sllav.

Bota demokratike është me Ukrainën. Mundësia për të pasur qasje në atë që po ndodh në Ukrainë kurrë nuk ka qenë më e madhe. 24 orë. Në të gjitha platformat elektronike, prej pamjeve satelitore e deri tek videot nëpër rrjete sociale.

Për ata që kanë përjetuar luftën e Kosovës 1998/99 është i gjallë krahasimi, por në kohë dhe hapësirë tjetër. Megjithatë diçka të përbashkët ka në çdo luftë, në çdo katastrofë humanitare, në çdo përmytje të jetës normale, kudo që ato ndodhin.

Me muaj të tërë ushtria ruse e rrethoi Ukrainën. Armatimi që qëndroi në arka dhe gëzhoja filloi të shpërthejë brenda territorit të një shteti me shumë milionë banorë sapo mbaruan Lojërat Olimpikë Dimërore në Kinë. Lëvizja që ndodh që me krismën e parë është zhvendosja e popullsisë civile. Si çdo njeri me zemër, mendje normale dhe ndjenja njerëzore më dhemb fati i qytetarëve ukrainas që braktisin ngrohtësinë shtëpisë dhe ndarjen e pjesëtarëve të familjes. Burrat mbesin në Ukrainë, pleqtë, fëmijët dhe gratë bëhen refugjatë.

Është tema e refugjatëve vlen një krahasim me pikëshikim individual, ashtu si e shoh personalisht. Më kujtohen largimet e familjeve shqiptare brenda në territorin e Kosovës. Në male, në nejlone në kushtet

të rënda.

Më kujtohen daljet në Maqedoni dhe Shqipëri. Poshtërimi nga policia dhe ushtria serbe ishte racist. Popullata e lodhur dhe rraskapitur me aq sa i zinte dora ishte si është më keq. Një popull i shtypur njëqind vjet nga Serbia padyshim që ka pamje të keqe refugjati.

Kur shikon ukrainasit që depertojnë në Poloni, Hungari dhe Rumani të bie në sy zotnillëku i refugjatit, ku fjala zotnillëk nuk duhet marrë me cinizëm. Ata dalin të veshur mirë, të larë e të qëruar me valixhe solide. Fëmijë të bukur, një racë e bardhë pa asnjë cen. Polonia dhe Hungaria, këto refuzuese të mëdha ndaj refugjatëve të Lindjes së Mesme, kanë hapur zemrën dhe derën në "refugjatët e bukur". I hapën dyert për vëllezërit e gjakut sllav. Asgjë kundër këtij solidarizimi, por nuk ke si të mos kesh respekt për shpirtin gjerman, që strehoi mbi një milion sirianë gjatë krizës në Siri.

Kur kamerat e medieve më të fuqishme japin pamje e "refugjatëve të bukur" m'u kujtua Shqipëria e vitit 1997, kur në botë dilnin pamjet me fytyrat më të shëmtuara të shqiptarëve, duke shtënë me kallashnikovë dhe armë të tjera anembanë Shqipërisë. Përzgjedhja e atyre fytyrave nga kameramanët e televizioneve botërore nuk ishte e rastit.

Më kujtohen pamjet e huaja televizive kur paraqitën masakrën e Likoshanit dhe Qirezit të 28 shkurtit 1998, ku pamja përfundonte me shqiptarin e besimit islam, duke bërë "dua" para kungjit të një varri të freskët. Një mesazh pa

tekst sikur thoshte: Mos t'ju dhimbsen, janë muslimanë.

Kur përcjell zhvillimet në Ukrainë nuk ke si të mos mendosh dhe të bësh krahasime tjera. Është fat për Kosovën që ShBA dhe bota liberal-demokratike e mbështeti në vitin 1999, dhe Kosova u çlirua nga pushtimi njëshekullor serb.

E, po ashtu është po aq fat dhe i vërtetë fakti që shqiptarët janë komuniteti më pro-perëndimor në rajon. Ukraina është sot guri i provës sesa i rëndësishëm është fakti i renditjes nga Perëndimi. Rënditja e botës së lirë përballë barbarisë, diktaturës, errësirës dhe çmendurisë.

Rënditja me Perëndimin është tregues se çfarë padrejtësie ndodh me lidhshimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që sot mbahet në burgun ndërkombëtar të Hagës. Njerëzit më pro-perëndimor, me proamerikanë të rajonit.

Mbahen në burg njerëzit më duarhatë të mundshëm që bënë luftë çlirimtare me orientim të duhur politik e civilizues dhe jo me automatikë e kallashnikovë të prodhimt kinez etj. Sa për AK-47 Kosova edhe sot do të ishte nën Serbi, sepse në të vërtetë çlirimi i Kosovës erdhi përmes mendjes dhe jo armës. Mendjes liberale, demokratike perëndimore.

Sa absurde dhe sa e padrejtë është mbajtja në burg e lidhshimit të UÇK-së, tregon më së miri Putini dhe fuqia e tij ushtarake. Kjo fuqi dhe çmenduri bëri që bota demokratike të bëj be e rr'fe se nuk ka synime sulmuese ndaj Rusisë.

Bëri që bota liberal demokratike të bëj be e rr'fe që nuk do të

ndërhyjë me forca të armatosura në Ukrainë, që nuk do të fluturojë mbi qiellin ukrainas, por do të mbrojë çdo inç vetëm të atyre shteteve që janë anëtare të NATO-s. Kjo natyrë frenuese humane e Perëndimit pa dyshim paraqet vlerë, por a ka mirëkuptim bota e barbarisë aziatike për këtë vlerë?

Jo, aspak. Putini po përpiqet ta zhbëjë një komb, një shtet një hapësirë territoriale. Me arrogancë, me kryeneqësi, me rigiditetin vulgar të shpirtit carist dhe gjithë trashëgiminë e diktaturës staliniste sovjetike. Shkatërrimi sistematik dhe gjakftohtë i Ukrainës dhe kujdesi që të mos hysh në konflikt me bishën e tërbuar tregon me së miri se pikërisht vlerat e demokracisë dhe skrupujt moralë të shoqërisë perëndimore Putini i merr si dobësi të kësaj bote. Andaj vepron me logjikën e të pafytyrit. Në kohën kur nuk mund ta ndalosh dhe ta thyesh bishën diktatoriale, del edhe keq në pah qëndrimi i rezervuar ndaj aleatëve, qoftë edhe të vegjël, ndaj popujve lojalë dhe besnikë. E, një popull dhe qytetërim i tillë janë shqiptarët e Kosovës.

Me 3 mars në Kuvendin e Kosovës gjithë deputetët e tij e nderuan me një minutë heshtje Ukrainën e vranë, përpos deputetëve serbë. Ata e kthyen përmbys letrën me flamurin e Ukrainës dhe e braktisën sallën. Nga zemra e tyre e nxorën pak Putin. Më 4 mars pati manifestim pro-rus në Beograd. Rast jashtëzakonisht i izoluar në botë, por mjerisht i pranishëm në Evropën Juglindore.

Ne këtë dritë përcaktimi sa keq që nga bota perëndimore injorohet faza e dytë e

shtetndërtimi të Kosovës. Nëse çlirimi dhe pavarësia e Kosovës janë kryevepër e SHBA-së dhe aleatëve të saj, pse të ngecë dhe të dështojë integrimi në NATO dhe në BE? Pse të dështojë pranimiti në OKB?

Në dritën e zhvillimeve të luftës në Ukrainë, në situatën kritike që krijoi agresioni ushtarak i Rusisë së Putinit, del edhe më fort në pah paradoksi i mbajtjes në arrest të lidhshimit të UÇK-së. Në kohën kur aktivizohet ideja gjithë-nihiliste se kur nuk ka Rusi, çka duhet bota pa të, e kur tërë civilizimi botëror kërcënohet me asgjësim të armëve bërthamore, sa absurde është të mbahet nën arrest dhe të trajtohet si kriminel lidhshipi i UÇK-së!

Në dritën e zhvillimeve në Ukrainë, pavarësisht çmimit, në fund do të ngadhënjëjë e drejta, njerëzorja, demokracia dhe liria. Do të ngadhënjëjë synimi lirishtashës përkundër bishës tiranike.

Në dritën e zhvillimeve në Ukrainë, pa dyshim, do të merr shkëlqim edhe më të madh lufta mbrojtëse e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në tri ditët e Epopesë së UÇK-së do të kuptohet edhe më mirë se vlera më e lartë kombëtare dhe historike e shqiptarëve të Kosovës dhe më gjerë është Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Lavdinë dhe të vërtetën e UÇK-së nuk mund ta ndryshojë, kontestojë dhe rishkruajë as Beogradi, as Moska as kundërshtarët e saj politikë brenda kombit.

Lavdi Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!  
Lavdi Komandantit Legjendar Adem Jashari!

Lavdi të rënëve për liri!  
Liri për çlirimtarët!



# Tatiana, Anatolij, Alisa, Miketa: I goditën qëllimisht. Pamjet që tronditën botën



Shpërthimi ndodhi para kishës, të dielën në orën nëntë të mëngjesit. Katër trupa në trotuar. Dy vëllezër Alisa 9-vjeçare dhe Miketa 18-vjeçar së bashku me nënën e tyre Tatiana 43-vjeçare. Jo shumë larg trupi i një të riu, Anatoli 27 vjeç. Kështu në një sekondë një familje e tërë u fshi nga një mortaja ruse. I pari që fotografoi skenën ishte Andriy Dubchak, një fotograf ukrainas që bashkëpunon me New York Times. Dhe është ai që tregon: “Po ecja nëpër rrugët e Irpinit, qyteza e sulmuar nga rusët në veriperëndim të Kievit. Kishte refugjatë që përpiqeshin të largoheshin. Po bëja foto dhe filmime. Pak më herët kisha dëgjuar të shtëna automatiku, po lëvizja me kolegë të tjerë. Në një moment ishte e qartë se rusët kishin parë nga distanca njerëzit që po largoheshin. Ishin me qindra: gra, fëmijë, të moshuar, të sëmurë po ndihmoheshin prej vullnetarëve. Në atë çast erdhi predha”. Nga video e tij mund të shihet shpërthimi. Rastësisht ka qenë duke filmuar dhe vetë ka mbetur i plagosur lehtë në kycin e

këmbës. Ka pluhur, copa, një vullnetar është goditur. Sapo pluhuri pastrohet, Andriy rinis filmimin e skenës, rrotullon kamerën dhe atëherë dëgjon britma, thirrje për ndihmë. Trupat janë në asfalt. “Vëllezërit vdiqën menjëherë. Kur vrapova drejt vendit, ata nuk merrnin më frymë. Mamja ishte pa ndjenja, por kishte puls. Ajo ndërroi jetë pak kohë më pas”. Viktima mes viktimave. Sipas refugjatëve, rrugët e Irpinit dhe fshatit aty pranë Buça janë të përgjakura me kufoma të braktisura. Civilët lëvizin ngadalë, të frikësuar nga shpërthimet, të frikësuar nga flakët, ecja mes mbeturinave me bagazhe rezulton e vështirë. Shumë prej tyre kanë ikur nga zona të tjera, nuk i njohin rrugët, shpesh nuk dinë as ku të shkojnë për të arritur në zonat e mbrojtura të Kievit. “Rusët luajnë si macja me miun. Momentet e gjata të qetësisë pasohen nga sekonda zjarri”, thonë dëshmitarët. Andriy nuk mund të kuptonte se kush ishin të vdekur. Askush nuk i njihje dhe në kaos të gjithë po



përpiqeshin të iknin. Ai vazhdon: “Pamjet e viktimave i postova në rrjetet sociale lokale dhe pas disa orësh më kontaktoi kumbara e fëmijëve. Mësova se janë një familje nga Donetsku që kanë ardhur për të jetuar në Irpin në kohën e pushtimit rus, në vitin 2014. Më pyeti se si vdiqën. Donte të dinte nëse kishin vuajtur, po

qante shumë. Të gjithë ata janë të mbyllur në bunkerë. Tatiana dhe dy fëmijët e saj duhej t’i bashkoheshin atyre. Tani kumbara do të duhet të rimarrë trupat e gjetur në morgun qendror të Kievit. Mes tyre do të bëjnë varrimin. Një komunitet i të zhvendosurve nga Donetsku tani banon në Kiev”.

Ai ka të ngulitur imazhin e vëllezërve. Miketa kishte një fytyrë të përgjakur. Të dy ishin shumë të mbuluar, bën ftohtë dhe njerëzit lëvizin me rroba të ngrohta. Edhe burri që ishte me ta vdiq shpejt, i kishte prerë arteriet inguinale. Nga rrëfimet e mbledhura në vend, mësojmë se ka ende shumë të plagosur të braktisur në rrugët e fshatrave të goditur. Shumë vdesin nga të ftohtit, pa asnjë ndihmë. Nuk e dimë nëse refugjatët po trajtohen nga rusët. “Njerëzit bëjnë përpjekje të mëdha për t’u shpëtuar rusëve. Dhe askush nuk na thotë se trupat ruse ndihmojnë ose trajtojnë të plagosurit. Në rastin më të mirë ata i lënë njerëzit të shpëtojnë”, thotë Andriy. Mes refugjatëve ka zëra se ushtarët rusë në Bucha janë me origjinë çeçene, të famshëm për mizorinë e tyre. Një fakt që kontribuon në nxitjen e frikës. Ai vetë flet për atë dyzet minuta ferri. “Pas mortajës të shtënat vazhduan fort. Rrugës së kthimit më është dashur të hidhem në tokë të paktën shtatë herë dhe jam strehuar dy herë në shtëpitë e braktisura”. / Corriere della sera – bota.al







## Liga Unike, me ndeshje derbi

Ndeshjet e Ligës Unike në të dyja konkurrencat do të zhvillohen në mesjavë. Te meshkujt janë disa ndeshje interesante, derisa dy prej tyre zhvillohen sot (e mërkurë) dhe dy nesër (e enjte). Në konkurrencën e femrave sot zhvillohet derbi mes Penzës dhe Flamurtarit

### **EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 8 MARS** - Liga Unike rikthehet në këtë mesjavë me ndeshjet e xhiros së 12-të. Edhe në këtë xhiro nuk do të mungojnë përballet derbi, derisa dy ndeshje zhvillohen sot, kurse dy të tjera zhvillohen nesër. Kampioni në fuqi dhe lideri aktual, Golden Eagle Ylli, do të përballet me skuadrën nga Shqipëria, Kamza Basket, e cila ka regjistruar dy fitore e nëntë humbje. Ylli është favorit në këtë ndeshje, pasi forma e tij në këtë ligë ka qenë mjaft e lartë, duke regjistruar dhjetë fitore e një humbje. Skuadra tjetër, Rahoveci, ka filluar këndelljen dhe në këtë

xhiro do të përballet me Vllazninë e Shkodrës. “Vreshtarët” kanë katër fitore e shtatë humbje, ndërsa shkodranët dy fitore e nëntë humbje. Të enjten do të zhvillohet një ndeshje derbi në mes të dy skuadrave nga Kosova, Prizrenit 16 dhe Pejës. Këto dy skuadra renditen në vendin e tretë, përkatësisht të dytin. Prizrenasit kanë shtatë fitore e katër humbje, ndërsa pejanët tetë fitore e tri humbje. Në ndeshjen e fundit për javën e 12-të do të jetë ajo mes dy klubeve nga Shqipëria, Tiranës dhe Teutës. Tiranasit kanë pesë fitore e gjashtë humbje, ndërsa durrsakët gjashtë fitore e pesë humbje, andaj pritet një sfidë

#### Liga Unike e Meshkujve - Xhiro 12

**Të mërkurën takohen:**  
17:00 Kamza - Golden Eagle Ylli  
19:00 Rahoveci - Vllaznia

**Të enjten takohen:**  
17:00 Prizreni 16 - Peja  
19:00 Tirana Neptun - Teuta

#### Liga Unike e Femrave - Java 6

**Të mërkurën takohen:**  
19:00 Penza - Flamurtari

**Të enjten takohen:**  
17:00 Prishtina - Tirana

rivalizuese dhe dramatike. Krahas Ligës Unike te meshkujt do të zhvillohen edhe ndeshjet e mbetura të



xhiros së gjashtë në konkurrencën e femrave. Derbi do të jetë ndërmjet Penzës dhe Flamurtarit, dy skuadra që janë në krye të renditjes. Kampionet e Kosovës kanë regjistruar gjashtë fitore e dy humbje, duke u renditur në vendin e dytë, ndërsa skuadra nga Vlora është në pozitën e parë me shtatë

fitore dhe një humbje. Humbjen e vetme skuadra shqiptare e ka pësuar nga klubi pejan. Takimi tjetër është ndërmjet dy skuadrave kryeqytetase, Prishtinës dhe Tiranës. Skuadra prishtinase ka pesë fitore e tri humbje, ndërsa ajo tiranase ka tetë humbje në tetë ndeshje të zhvilluara, duke qenë skuadra e vetme pa fitore.

## Sot tri ndeshje në Superligë, nesër derbi Drita Gjilani



### “Epoka e re”

**PRISHTINË, 8 MARS** - Java e 24-të në Superligën e Kosovës në futboll zhvillohet në këtë mesjavë me disa ndeshje mjaft interesante, derisa derbi në mes të Dritës dhe Gjilanit zhvillohet të enjten nga ora 13:00. Ballkani, që është duke kaluar nëpër një formë fantastike, sot (e

mërkurë) do të takohet me Malishevën. Edhe në këtë ndeshje djelmoshat e Ilir Dajës do të kërkojnë tri pikë në mënyrë që ta ruajnë dallimin me skuadrat përcjellëse. Malisheva, në anën tjetër, nuk hyn në këtë ndeshje me flamur të bardhë, pasi kërkon pikët që do ta mbajnë në garë për mbijetesë. Ndeshje interesante do të jetë edhe ajo në mes të

Ulpianës dhe Dukagjinit, derisa Feronikeli e pret Prishtinën që po kalon nëpër një krizë të rezultateve. Derbi në mes të Dritës dhe Gjilanit pritet të jetë interesante si asnjëherë më parë për faktin se këto dy skuadra janë duke luftuar për titull dhe do ta kërkojë maksimumin e pikëve për të mos lejuar shpëputjen e Ballkanit. Ndërsa Llapi në


#### BKT SUPERLIGA

**Të mërkurën takohen:**  
13:00 Malisheva - Ballkani  
13:00 Ulpiana - Dukagjini  
13:00 Feronikeli - Prishtina

#### TË ENJTEN TAKOHEN:

13:00 Drita - Gjilani  
13:00 Llapi - Drenica

## Vritet edhe nënkampioni i botës në kikkoks



**CHERNIGOVONE, 8 MARS** - Edhe një tjetër sportist është vrarë në Ukrainë nga ushtria ruse. Bëhet fjalë për Yevhen Zvonok, i cili ndërroi jetë nga plagët e marra gjatë luftimeve në qytetin Chernigovone. Mediet ukrainase njoftojnë se 22-vjeçari ndërroi jetë nga bombardimet e ushtrisë ruse. Zvonok, kampion ukrainas, e

kishte fituar medaljen e argjendtë edhe në Kampionat Botëror. Pra, ai ishte nënkampion botëror dhe pritej shumë nga ai. Në fillimit të luftës, Zvonok, gjersa ishte duke luftuar në mbrojtje të Ukrainës, u vra nga sulmet ruse. Më pas u gjet trupi i tij në shkollën në gërmadhat e shkollës që ishte bombarduar. “Askush nuk e

priste që ai t’i merrte armët. Ai ishte një djalë i qetë dhe i mirë, një sportist i talentuar. Por, kur erdhi koha për ta mbrojtur vendin, ai nuk mendoj fare”, theksoi shoku dhe trajneri i tij, Sergey Lysyuk. “Ai ishte një djalë trim që nuk u dorëzua kurrë. Ai i pranoi të gjitha sfidat. Ne kishim planifikuar gara ndërkombëtare me të, por ai

iku para kohe”, ka shtuar ai. “Ai e kishte nisur karrierën sportive. Vitin e kaluar ishte i dyti në Botërorin e Kikkoksit dhe kampion i Ukrainës. Ne ishim duke e përgatitur atë për gara ndërkombëtare dhe në fund të marsit ai do të duhej të merrte pjesë në kampionatin ukrainas në Odessa”, bëri me dije trajneri i sportistit.

## Besa fiton titullin e kampionit të kadetët

Pejë, 8 mars - Ka përfunduar edicioni 2021/2022 në ligën e kadetëve të Kosovës në hendboll. Ndeshjet e fundit janë luajtur në fundjavë, para atyre të Superligës së seniorëve. Gara për titull të kampionit ishte e fortë, ndërsa në fund titullin e ka fituar

skuadra pejane, Besa Famgas. Besa mblodhi 33 pikë nga 18 ndeshje. Kampionatin me 32 pikë e përfundoi Vëllaznimi i Gjakovës, ndërsa Deçani mblodhi 31 pikë dhe përfundoi i treti. Besa Famgas në xhiron e fundit e ka mposhtur Trepçën në Mitrovicë me

rezultat 30:16 dhe kështu ka siguruar pozitën e parë. Fitore shënoi edhe Vëllaznimi, 42:20, ndaj Drenicës. Deçani e mposhti Prishtinën me rezultat 27:24. Gëzon fakti se në skenë ka dalë një gjeneratë me potencial, që premtim shumë për të ardhmen.





## Marku: Përgatitjet po shkojnë mirë, mezi pres sfidën e radhës

Njukasëll, 8 mars - Boksieri shqiptar Florian Marku ka konfirmuar se është në formë të mirë sportive dhe se përgatitjet për duelin e radhës, atë të datës 2 prill, po shkojnë mirë. Në Njukasëll të Anglisë ai do të

përballet me boksierin vendës Chris Jenkins. "Përgatitjet po shkojnë shumë mirë", ka thënë Marku në faqen zyrtare në "Facebook". "Mezi po e pres sfidën e radhës ndaj anglezit Jenkins", ka shtuar

Marku, i pamposhtur në karrierën e tij. Boksieri shqiptar numëron 10 fitore dhe 1 barazim në karrierën e tij. Florian Marku mban titullin kampion bote në kategorinë IBF International në peshën

"welter", titull që e ka fituar në shtator të vitit të kaluar. Kjo do të jetë hera e dytë për të që e mbron këtë trofe. Dueli ndaj Chris Jenkins (22 fitore, 4 humbje e 3 barazime) është me 10 raunde.



## 'Dardanët' premtajnë spektakël në ndeshjet e marsit

PRISHTINË, 8 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll këtë muaj do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore, me Burkina Fason dhe me Zvicërën. Tifozët "dardanët" mezi po presin t'i shohin më të dashurit e tyre duke luajtur. Tifozët besnikë të Kosovës premtajnë spektakël në ndeshjen me Burkina Fason, e cila do të luhet më 24 mars në Prishtinë. Ata njëherësh i ftojnë të gjithë që t'i bashkohen festës në muajin mars, i cili është i veçantë për vendin tonë, pasi konsiderohet si muaj i rezistencës, i lavdisë dhe i krenarisë. "Dardanët" kërkojnë që të gjithë të kontribuojnë që të rikthehet gjallëria e dikurshme në Kombëtare, e cila e kaloi një vit të zbehtë. "Marsi i rezistencës, lavdisë dhe krenarisë për popullin tonë - na gjen me terminet e ndeshjeve të Përfaqësueses së Kosovës. Gjatë këtij muaji, më 24 dhe 29 mars, ekipi ynë përfaqësues do të përballet me dy kundërshtarë në ndeshje miqësore: Burkina Fason në Prishtinë, gjegjësisht Zvicërën në



Zurich. Lidhja emocionale e popullit tonë që është karakterizuar me kombëtarë e Kosovës ka bërë që ndeshjet e saj mos ta përçojnë vetëm simbolikën sportive, por të jenë më të vlefshme sesa kaq. Ato gjithmonë kanë ngjallur dashuri, entuziazëm, pasion dhe rikthim të disponimit të përgjithshëm në masë. Pikërisht këto tipare kërkojmë t'i rikthejmë sërish me anë të këtij paralajmërimi, ku ju

ftojme të bëheni pjesë si tifozë të dy ndeshjeve miqësore që na presin në këtë muaj", thuhet në njoftimin e "dardanëve". "Dardanët" në ndeshjen ndaj Burkina Fasos premtajnë mbështetje të plotë për djelmohat tanë në fushë, si dhe organizim e përgatitje që s'do t'i lënë asgjë rastësisë. I ftojme të gjithë t'ia rikthejmë kombëtares sonë atë shkëndijën e nevojshme, ku klima dhe ambienti i ngrohtë i organizuar nga ne, mundëson që lojtarët ta japin më të mirën prej vetes dhe kësaj bashkërisht të korrim rezultate të mirëseardhura. Duam ta rikthejmë atë gjallëri në ndeshjet e kombëtares sonë bëhen temë e ditës për çdokënd, në çdo hapësirë, nga secila shtresë moshe. Ndërkaq sa i përket ndeshjes ndaj Zvicrës, porsa të komunikohet nga FFK pjesa e biletave që do të dalin në shitje, ne do t'ju informojmë me kohë për mënyrën dhe kohën e organizimit", thuhet në njoftimin e "dardanëve".

## Lakersat dhe Golden State humbasin sërish, fitojnë Miami e Philadelphia

MIAMI, 8 MARS - Miami vijon të kryesojë renditjen në Konferencën e Lindjes, pas fitores me rezultat 123-106 ndaj Houstonit. Ndeshje e dominuar nga skuadra e Miamit, ku u dallua Herro me 31 pikë. Fitoi edhe Philadelphia, që mundi me rezultat 121-106 rivalët e Chicagos dhe tashmë forca e dytë në Lindje. Për Philadelphian u dallua Joel Embiid me 43 pikë e 14



rebounde. Tjetër zhgënjim për Lakersat, që u mundën me rezultat 117-110 nga San Antonio. Mungesa e LeBron Jamesit u ndje te Lakersat, ndërsa për spursat u dallua Murray me 26 pikë e 10

rebounde. Vijon kriza e Golden States, që pësoi humbjen e pestë radhazi. Warriorsi u mund me rezultat 131-124 nga Denveri, sfidë ku u dallua Jokic me 32 pikë, 15 rebounde e 13 asistime.

### REZULTATET

Detroit - Atlanta	113-110
Philadelphia - Chicago	121-106
Miami - Houston	123-106
Minnesota - Portland	124-81
Dallas - Utah Jazz	111-103
San Antonio - Lakers	117-110
Denver - Golden State	131-124
Sacramento - New York	115-131

### SHKURT

#### Tre futbollistë shqiptarë në formacionin e javës në Zvicër

Futbollistët shqiptarë kanë shkëlqyer në paraqitjet e tyre javën e fundit në kampionatin zviceran. Sipas "Sports.ch", tre prej tyre janë përfshirë në 11-shen më të mirë të javës. Në formacionin e xhiros së 21-të janë përfshirë Mirind Kryeziu, Aldon Jashari dhe Kastriot Imeri. Njëherësh këta cilësohen edhe si transferet më të qëlluara të afatit kalimtar dimëror. Lojtarët shqiptarë njihen për nga numri i madh i tyre në ligen elitare në Zvicër, por edhe për paraqitjet fantastike që bëjnë.

#### Gjimshiti në listën e transferimeve të Interit

Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Berat Gjimshiti, në sezonet e fundit është rritur shumë si futbollist. Mbrojtësi kuqezi ka përfunduar në listën e dëshirave të trajnerit të Interit, Simone Inzaghi. Klubi zikaltër pritet të kryejë një revolucion në repartin e mbrojtjes sezonin e ardhshëm pasi në listë për t'u larguar janë Ranochia, Kolarov dhe D'Ambrosio dhe De Vrij. Kontrata e mbrojtësit kuqezi me Atalantën skadon pas një viti. Aktualisht bergamaskët e vlerësojnë me 15 milionë euro kartonin e Gjimshitit, por mund t'i ulin pretendimet për të mos e humbur 29-vjeçarin shqiptar me parametra zero.

#### Shtyhet ndeshja Skoci - Ukrainë

Për shkak të luftës mes Rusisë dhe Ukrainës, FIFA ka vendosur ta shtyjë ndeshjen në mes të Skocisë dhe Ukrainës, e vlefshme për kualifikimin për Kampionatin Botëror "Qatar 2022". Gjysmëfinalja e "play-off"-it, e paraparë të luhet më 24 mars, ka mundësi të luhet në qershor. Fituesi i kësaj ndeshjeje do të përballet me Australinë ose Walesin, për të kërkuar një vend në Qatar. Liga ukrainase e futbollit i ka ndaluar të gjitha aktivitetet për shkak të luftës, shkruan BBC. Ndërkaq Rusia si rezultat i sulmit në Ukrainë është përjashtuar nga FIFA dhe UEFA nga të gjitha aktivitetet e futbollit.

#### Laporta: Vendimi për largimin e Messit ishte i dhimbshëm, por nuk pendohem

Në intervistën që dha Joan Laporta për Barça TV, pikërisht një vit pas marrjes së presidencës së katalanasve, një nga temat e bisedës ishte edhe largimi i Leo Messit te PSG-së. Ai tha se largimi i tij ishte vërtet i dhimbshëm dhe i trishtuar. "Ishte i dhimbshëm. Nëse bëj një bilanc, ishte vendimi më i trishtuar nga të gjithë dhe nuk do të kisha dashur kurrë ta kisha marrë por, gjithashtu, nuk pendohem sepse doja ta vendosja institucionin përpara gjithçkaje, madje edhe përpara trajnerëve dhe më të mirëve", ka thënë ai. "Situata ekonomike e klubit që trashëguam ishte një katastrofë. Dhe sado që donim të qëndronte, u përballëm me një realitet të frikshëm. Messi nuk është më me ne, por Barça vazhdon rrugën e suksesit. Me punë dhe vendime të mirëmenduara e ardhmja e klubit është e sigurt", ka përfunduar ai.

## 16 futbollistë pritet të largohen nga Unitedi

E ardhmja e 16 lojtarëve të Manchester Unitedit është në dyshime me klubin që pritet të përballet me një revolucion masiv në verë. Paul Pogba, Jesse Lingard, Juan Mata dhe Edinson Cavani do të largohen të gjithë si transferime të lira nëse nuk mund të bien dakord për marrëveshje të reja.

Ndërkohë, raportimet e muajve të fundit kanë thënë se Cristiano Ronaldo mund të largohet nëse Unitedi nuk kualifikohet në Ligën e Kampionëve. Një largim i mundshëm duket edhe ai i sulmuesit Marcus Rashford. Reprerentuesi anglez mendohet të jetë i pakënaqur me mungesën e kohës së

tij të lojës nën drejtimin e Ralf Rangnick. Mason Greenwood është pezulluar për një kohë të pacaktuar që kur u arrestua me dyshimin për përdhunim, sulm dhe kërcënim për të vrarë një grua. Portieri Dean Henderson ka vazhduar të jetë si portier i dytë i papërdorur pas David de

Geas dhe është i vendosur të largohet në kërkim të më shumë minutave. Futbollistët e tjerë që pritet të largohen janë Anthony Martial, Diogo Dalot, Aaron Wan-Bissaka, Donny van de Beek, Phil Jones, Brandon Williams, Andreas Pereira, Facundo Pellistri dhe Tahith Chong.





**Ndërmarrja Publike Lokale  
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë**



Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, si dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh.A. Prishtinë, shpallë:

**KONKURSET**

**Për pozitat:**

**I. Teknik/e i/e IT-së, një (1)**

**Departamenti i Administratës, Sektori i IT, nr. i referencës: 04/6**

**Detvat dhe përgjegjësitë**

- Instalimin, konfigurimin, mirëmbajtjen e rrjetit dhe pajisjeve të IT-së (PC, Printer, Fotokopje, etj.);
- Zhvillimi i Softuerit, po ashtu e mirëmban Ueb Sajtin;
- Bën zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të reja që mund të zhvillohen brenda IT-së për nevojat e ndërmarrjes;
- Ndhmon punëtorët e ndërmarrjes në raste të përdorimit të pajisjeve dhe programeve të IT-së;
- Ndhmon në futjen e shënimeve në sisteme të ndryshme si ueb sajt e sisteme tjera;
- Intervenon sipas kërkesave të zyrtarëve në të gjitha rastet për evitimin e prishjeve teknike në aparaturën kompjuterike.

**Kualifikimi dhe përgatitja profesionale**

- Shkollimi Universitar;
- Së paku një (1) vit përvojë pune;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathësi kompjuterike (Microsoft Office).

**Procedura e Konkurrimit**

Kandidati-ja për pozitën **Teknik/e i/e IT-së** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit kopje të noterizuar;
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor nga ATK-ja;
- Kopjen e Lejes së Njoftimit dhe Ekstraktin e Lindjes;
- Letër motivimin.

**Kontratë pune për periudhë të caktuar: gjashtë (6) muaj punë provuese, në raste të vlerësimit pozitiv të performancës në punë plus tre (3) vite të tjera me mundësi vazhdimi.**

**II. Dispeçer/e (Menaxher/e i/e Kontrollit të vendparkingjeve), tre (3)**

**Departamenti i Operimeve, Sektori i Kontrollit të vendparkingjeve, nr. i referencës: 05/3**

**Detvat dhe përgjegjësitë**

- Mbikëqyrja dhe puna me personelin i cili punon në teren;
- Evidentimi i punës jo të rregullt në teren, evidentimi i punës jo të rregullt të sistemit dhe mënjanimi i gabimeve;
- Mirëmbajtja e kompjuterëve portativ (verifikimi i korrektesisë së punës të kompjuterëve portativ dhe pajisjeve tjera);
- Përgatitja e kompjuterëve portativ dhe pajisjeve përcjellëse për punë në terren (mbushja e baterive, rregullimi i parametrave të pajisjeve dhe printerëve);
- Dhënie e pajisjeve për punën e kontrollorëve (kompjuterin portativ PocketPC dhe printerin portativ) në fillim të ndërrimit dhe pranimit në fund të ndërrimit.

**Kualifikimi dhe përgatitja profesionale**

- Shkollimi Universitar;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathësi kompjuterike (Microsoft Office);
- Preferohet të ketë patentë shofer, kategoria B.

**Procedura e Konkurrimit**

Kandidati-ja për pozitën **Dispeçer/e (Menaxher/e i/e Kontrollit të vendparkingjeve)** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit kopje të noterizuar;
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);

- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor nga ATK-ja;
- Kopjen e Lejes së Njoftimit dhe Ekstraktin e Lindjes;
- Letër motivimin.

**Kontratë pune për periudhë të caktuar: gjashtë (6) muaj punë provuese, në raste të vlerësimit pozitiv të performancës në punë plus tre (3) vite të tjera me mundësi vazhdimi.**

**III. Kontrollor/e, pesëmbëdhjetë (15)**

**Departamenti i Operimeve, Sektori i Kontrollit të vendparkingjeve, nr. i referencës: 05/3**

**Detvat dhe përgjegjësitë**

- Kontrollimi i korrektesisë së parkimit në parkingjet rrugore dhe lëshimi i dënimeve kontraktuale;
- Merr nga dispeçeri kompjuterin portativ në fillim të ndërrimit dhe lajmërohet për punë në të;
- Vizita në vendet e përcaktuara;
- Evidentimin e veturave, përkatësisht shfrytëzuesve të parkingjeve të cilët kanë bërë shkelje të dispozitave të rregulloreve të ndërmarrjes për organizimin dhe mënyrën e pagesës së parkimit;
- Në kompjuterin portativ regjistron të dhënat e automjetit dhe lokacionin e shkeljes;
- Lëshon urdhrin për pagesën e dënimit kontraktual, shfrytëzuesit të parkimit i/e cili/a ka bërë shkeljen e rregulloreve të ndërmarrjes;
- Pas përfundimit të ndërrimit e kthen kompjuterin portativ tek Dispeçeri.

**Kualifikimi dhe përgatitja profesionale**

- Diploma e Shkollës së Mesme;
- Preferohet të ketë përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Preferohet të ketë shkathësi kompjuterike elementare;
- Preferohet të ketë patentë shofer, kategoria B.

**Procedura e Konkurrimit**

Kandidati-ja për pozitën **Kontrollor/e** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- Dëshminë e Shkollimit kopje të noterizuar;
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor nga ATK-ja;
- Kopjen e Lejes së Njoftimit dhe Ekstraktin e Lindjes.

**Kontratë pune për periudhë të caktuar: gjashtë (6) muaj punë provuese, në raste të vlerësimit pozitiv të performancës në punë plus tre (3) vite të tjera me mundësi vazhdimi.**

**IV. Inkasant/c, pesë (5)**

**Departamenti i Operimeve, Sektori i Parkingjeve me Laura, nr. i referencës: 05/4**

**Detvat dhe përgjegjësitë**

- Të kenë cilësi të menaxhimit, faturave, të hollave dhe besueshmëri, cilësi të komunikimit me konsumator, aftësi të marrjes së përgjithshme material;
- Të identifikoj konsumatorët e ri, të përcjell gjendjen e konsumatorëve ekzistues, të ngarkohet me fatura, të inkasoj, të dorëzoj pazarin ditore çdo ditë;
- Të mbajë shënime për secilin konsumator, kërkesave, ankesave dhe sugjerimeve dhe t'i delegoj ato për shqyrtim;
- Të menaxhoj vonesat në pagesa së bashku me udhëheqësin e sektorit;
- Të realizoj normën e inkasimit sipas akteve normative në fuqi të ndërmarrjes.

**Kualifikimi dhe përgatitja profesionale**

- Diploma e Shkollës së Mesme;
- Preferohet të ketë përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Preferohet të ketë shkathësi kompjuterike elementare;
- Preferohet të ketë patentë shofer, kategoria B.

**Procedura e Konkurrimit**

Kandidati-ja për pozitën **Inkasant/e** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- Dëshminë e Shkollimit kopje të noterizuar;
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor nga ATK-ja;
- Kopjen e Lejes së Njoftimit dhe Ekstraktin e Lindjes.

**Kontratë pune për periudhë të caktuar: gjashtë (6) muaj punë provuese, në raste të vlerësimit pozitiv të performancës në punë plus tre (3) vite të tjera me mundësi vazhdimi.**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: Selia e Ndërmarrjes Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh.A. Prishtinë, Rr. "Luan Haradinaj", p.n., Pallati i Rinisë dhe Sporteve (ish ASK), 10000, Prishtinë, Kosovë, aplikacioni merret në selinë e NPL "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë, si dhe në ueb faqen [www.prishtinaparking.net](http://www.prishtinaparking.net). Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen. **Konkursi është i hapur nga data: 08 Mars 2022 – 22 Mars 2022, ora 16:00.**



# NJOFTIM ZBRITJE MALLI DERI 75 %

Biznesi individual me numër Unik Identifikues 810497398 me seli në Llapna Sell dhe nr. kontakti 044777778, për arsye të likuiditetit, njofton të interesuarit qytetarë si persona fizik apo juridik mund të blejnë produkte kozmetike grimi të brendeve botërore MAX FACTOR, ARTDECO, parfuma, deodorante, qumësht trupi etj, të firmave botërore BOSS, BALDESSARINI, D&G, Lacoste, Moschino, Valentino, Versace, ngjyra flokësh, pajisje tretmani dhe mirëmbajtje floku të prodhuesit Italian DIKSON.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 


[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Blerta Vitaku shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të Gjimnazit "Xhevded Doda" Prishtinë.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

